



## Albania – Kosovo

IPA Cross Border Cooperation Programme

### Shpallet Thirrja e parë për projekt propozime Programi IPA II BNK Shqipëri-Kosovë 2014-2020

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë 2014-2020, **me datë 11 Janar 2017**, u shpall Thirrja e Parë për projekt propozime. Thirrja do të qëndrojë e hapur deri më datë **16 Mars 2017**. Buxheti në total i thirrjes (përfshirë dhe bashkëfinancimin) është 2.040.000 Euro.

Kjo thirrje është e hapur për dy nga tre Akset Prioritare të Programit, sipas 2 objektivave përkatës specifike, si më poshtë:

***Aksi Prioritar B: Inkurajimi i Turizmit, Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore***

Objektivi Specifik 1: Valorizimi i Turizmit dhe Trashëgimive Natyrore dhe Kulturore për promovimin e zhvillimit ekonomik të zonës ndërkufitare.

***Aksi Prioritar C: Investime në rini, arsim dhe aftësi***

Objektivi Specifik 2: Nxitja e Integritimit social dhe ekonomik të të rinjve.

Gjatë hartimit të projekt propozimeve është e domosdoshme që aplikantët të studiojnë me kujdes të gjitha dokumentet e Programit, duke përfshirë tekstin e Programit të Bashkëpunimit dhe Manualin e Programit, si dhe dokumentet e veçanta që lidhen me thirrjen (në veçanti Termat e Referencës).

Më shumë informacion mbi kriteret e thirrjes dhe paketën e aplikimit do të gjeni në linkun e mëposhtëm:

<https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome&PubliList=15&orderby=upd&orderbyad=Desc&searchtype=RS&aofr=154390>

Deri në 21 ditë para mbylljes së thirrjes, aplikantët mund të dërgojnë pyetjet e tyre elektronikisht në emailin: [DELEGATION-ALBANIA-TENDERS@eeas.europa.eu](mailto:DELEGATION-ALBANIA-TENDERS@eeas.europa.eu), ose në numrin e Faksit [+355 4 2270678](tel:+35542270678), duke përcaktuar qartë numrin e referencës të kësaj Thirrje për projekt propozime. Të gjitha pyetjet do të grupohen dhe përgjigjet do të publikohen në faqen e internetit të EuropeAid <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome>, dhe në atë të Autoritetit Kontraktues [https://eeas.europa.eu/delegations/albania\\_en](https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en).